

Përmbledhje

PROKURORI NË PROKURORINË E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, ROBERT KOTE PËRBALLET ME PROCESIN E RIVLERËSIMIT PRANË KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

**RAPORTIM PARAPRAK I SEANCËS DËGJIMORE
DATË 15/12/2022 PRANË KPK:**

KPK informoi se hetimi administrativ mbi subjektin e rivlerësimit është përfunduar për të tre kriteret e rivlerësimit, atë të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

Raporti i ILDKPKI rezultoi pozitiv por Komisioni në hetimin administrativ ka konstatuar mungesë të burimeve të ligjshme financiare.

DSIK ka evidentuar kualifikimin e gabuar ligjor në një procedim penal, ndaj një individi me precedent të mëparshëm penalë, i cili mund të klasifikohet si një kontakt i i pa përshtatshëm, në kuptim të nenit 3/15 të ligjit 84/2016.

Raporti i KLP-së, në vlerësimin e kriterit profesional, nxirrte në pah aftësi të mira të subjektit për të interpretuar ligjin, analizuar jurisprudencën dhe për të përdorur arsyetim eficient ligjor.



Raporti i përditësuar i DSIK, i depozituar në KPK, ngre pyetje për kontakte të papërshtatshme për subjektin e rivlerësimit z. Robert Kote, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Më datë 15.12.2022 ora 12:00, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Z. Robert Kote, prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Trupa gjykuese përbëhej nga z. Lulzim Hamitaj (Kryesues), znj. Valbona Sanxhaktari (Relatore) dhe znj. Genta Tafa (Bungo) (Anëtare), si dhe u asistua nga vëzhguesi ndërkombëtar z. Gerrit Sprenger, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

KPK informoi se hetimi administrativ mbi subjektin e rivlerësimit është përfunduar për të tri kriteret, atë të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016. Gjatë seancës dëgjimore, u vërejt se subjekti nuk u përfaqësua nga ana e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, si dhe nuk paraqiti kërkesa paraprake apo procedurale në lidhje me trupën gjykuese. Relatimi për kriterin e pasurisë, në raport kohor me dy kriteret e tjera atë të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, zuri pjesën më të madhe të seancës dëgjimore.

Lidhur me kriterin e pasurisë, raporti i ILDKPKI tregonte balanca pozitive për subjektin e rivlerësimit. Ndryshe nga ky raport, Komisioni në hetimin administrativ ka konstatuar mungesë të burimeve të ligjshme për disa vite, sa i përket 35 udhëtimeve të kryera jashtë Shqipërisë, si dhe transfertat bankare drejtuar vajzës së tij për vazhdimin e studimeve në Vienë. Pikëpyetje u ngritën mbi shitjen e një automjeti nga ana e subjektit 2 vite më vonë nga dita e blerjes, me një shumë gati 2 fish më të lartë se çmimi i blerë. Subjektit iu drejtuan pyetje nga trupa gjykuese dhe vëzhguesi ndërkombëtar, ndërkohë që ai zgjodhi t'i përgjigjej me pranimin e vetë-përgjegjësisë.

Pas kërkesës së Komisionit për përditësim të raportit, DSIK ka evidentuar kualifikimin e gabuar ligjor në një procedim penal, ndaj një individi me precedent të mëparshëm penalë, i cili mund të klasifikohet si një kontakt i i pa përshtatshëm, në kuptim të nenit 3/15 të ligjit 84/2016.

Raporti i KLP-së, në vlerësimin e kriterit profesional, nxirrte në pah aftësi të mira të subjektit për të interpretuar ligjin, analizuar jurisprudencën dhe për të përdorur arsyetim eficient ligjor. 7 denoncime ishin depozituar nga publiku, por vetëm 1 u relatua në seancë ku denoncuesi pretendonte ndryshim të pabazuar të kualifikimit ligjor nga ana e subjektit, ndërkohë që çështja është nën shqyrtim gjyqësor.

Në përfundim të seancës, Komisioni caktoi datën 19.12.2022, ora 9:40, për shpalljen e vendimit përfundimtar.